

IT Panakeia shpk
Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 20

"IT Panakeia" shpk
(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017**

	Shenime	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	2,373,945	17,456,647
Llogari te arketueshme tregetare	5	578,932	576,181
Llogari te arketueshme nga palet e lidhura	6	19,558,350	11,384,887
Te tjera llogari te arketueshme	7	4,489,690	2,324,904
Inventari	8	3,148,433	2,386,122
Shpenzime te shtyra	9	366,600	-
Total Aktive Afatshkurtra		30,515,950	34,128,741
Aktivjet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	2,317,052	2,842,798
Total aktive afatgjata		2,317,052	2,842,798
Total Aktive		32,833,002	36,971,539
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari te pagueshme tregetare	11	1,214,256	432,290
Llogari te pagueshme ndaj paleve te lidhura	12	1,469,423	481,576
Detyrime tatimore	13	1,732,624	8,533,945
Te tjera detyrime	14	8,775,786	8,000,000
Total Detyrime afatshkurtra		13,192,089	17,447,811
Detyrime afatgjata			
Total Detyrime afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		13,192,089	17,447,811
Kapitali aksionar			
Kapitali i nenshkruar	15	400,000	400,000
Rezerva ligjore		40,000	40,000
Rezerva te tjera		19,083,728	12,012,523
Fitimi i ushtrimit		117,185	7,071,205
Total kapitali aksionar		19,640,913	19,523,728
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		32,833,002	36,971,539

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"IT Panakeia" shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	She nim e	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit	16	30,589,015	48,081,803
Te ardhura te tjera te shfrytezimit	17	(31,741)	(9,354)
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		(16,474,343)	(10,338,173)
Lenda e pare dhe materiale te			
1) konsumueshme	18	(8,265,907)	(3,752,355)
2) Te tjera shpenzime	19	(8,208,436)	(6,585,818)
Shpenzime te personelit	20	(13,245,935)	(28,577,012)
1) Paga dhe shperblime		(11,592,073)	(27,158,321)
Shpenzime te sigurimeve			
shoqerore/shendetsore (paraqitur vecmas			
2) nga shpenzimet per pension)		(1,653,862)	(1,418,691)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	10	(659,358)	(775,276)
Shpenzime te tjera te shfrytezimit	21	(302)	(302)
Te ardhura te tjera		-	-
Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve te mbajtura si aktive afatshkurtra		-	-
Shpenzime financiare		(30)	(25)
Shpenzime interesi dhe shpenzime te			
ngjashme (paraqitur vecmas shpenzimet			
per t'u paguar tek njesite ekonomike brenda			
1) grupit)	22	(30)	(25)
Pjese e fitimit/humbjes nga pjesmarrjet			
Fitimi/humbja para tatimit		177,306	8,381,661
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	23	(60,121)	(1,310,456)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(60,121)	(1,310,456)
Fitimi/humbja e vitit		117,185	7,071,205

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"IT Panakeia" shpk

(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	400,000	40,000	14,310,993	1,501,530	16,252,523
Effekti i ndryshimeve në politikat kontabël					
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2015					
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:					-
Fitimi / Humbja e vitit				7,071,205	7,071,205
Lëvizjet përmes kapitalit			1,501,530	(1,501,530)	-
Dividendë të paguar			(3,800,000)		(3,800,000)
					-
Pozicioni financiar i rideklaruar më 31 dhjetor 2016	400,000	40,000	12,012,523	7,071,205	19,523,728
Pozicioni financiar i rideklaruar më 1 janar 2017					
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:					
Fitimi / Humbja e vitit				117,185	117,185
Lëvizjet përmes kapitalit			7,071,205	(7,071,205)	-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	400,000	40,000	19,083,728	117,185	19,640,913

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori IT Panakeia shpk më 26.03.2018 dhe janë firmosur si më poshtë:

Alpert Bregu
Alpert BREGU
Ekonomist




IRALDA MITRO
Iralda MITRO
Administrator



"IT Panakeia" shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	She nim e	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative			
Fitim / Humbja e vitit		117,185	7,071,205
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:			
Shpenzimet financiare jomonetare		17,717	144,730
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar		60,121	1,310,456
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		659,358	775,276
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:			
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera		(10,767,721)	(5,778,289)
Rënie/(rritje) në inventarë		(762,311)	(2,386,122)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme		(5,031,478)	5,134,060
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit		775,786	(297,430)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit		(14,931,343)	5,973,886
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit			
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale		(133,612)	(612,046)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		-	1,836,355
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		(133,612)	1,224,309
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit			
Interes i paguar		(30)	(25)
Dividendë të paguar		-	(3,800,000)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		(30)	(3,800,025)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare		(15,064,985)	3,398,170
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar		17,456,647	14,203,207
<i>Efekt i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>		(17,717)	(144,730)
Mjete monetare dhe ekuivalentë më 31 dhjetor	4	2,373,945	17,456,647

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "IT Panakeia" Shpk është regjistruar si shoqëri me përgjegjesi të kufizuar pranë rregjistrave të Qendres Kombëtare të Regjistrimeve me datë 20/03/2007. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave perkatëse të ligjit Nr.7638 datë 19 Nentor 1992 "Per Shoqëritë Tregtare" dhe statuti i saj.

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 400,000 leke i zotëruar 100% nga ortakët i vetëm i shoqërisë Investment SHERKO - ikub GROUP shpk.

Administrator i shoqërisë është Znj. Iralda Mitro.

Selia e shoqërisë ndodhet në rrugën Ismail Qemali, Pallati 27, Shk1, Nr. 30, Tirane. Ajo është e regjistruar në Degen e Tatimeve, Tirane me NIPT K71702025M.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie është "Konceptimi, zhvillimi, implementimi, testimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të teknologjive të informacionit dhe komunikimit. Import-eksport të mallrave, materialeve, shërbimeve etj. Tregtim elektronik dhe fizik i mallrave, materialeve, shërbimeve, të çfaredolloj natyre ato qofshin, të lejuara nga ligji. Aktivitetet tregtar, financiar, dhenie-marrje me qira etj".

Më 31 dhjetor 2017 Shoqëria kishte 20 punonjës (2016: 20 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve të detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
Euro/LEK	132.95	135.23
USD/ LEK	111.10	128.17

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë

(Vlerat janë në Lek)

nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet me vlerën nominale. Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapitale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.2. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.3. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivitetet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivitetit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivitetit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktiviteti afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyrën dhe kantierin	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.4. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësi ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.5. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.6. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Shoqëria ka vetëm qira operative.

3.7. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.8. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë. Shoqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

3.9. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.10. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.11. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

“IT Panakeia” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	ne Lek	ne Lek
Mjete monetare ne banke	1,519,251	16,114,325
<i>Llogari rrjedhese</i>	1,519,251	16,114,325
Mjete monetare ne arke	854,694	1,342,322
	2,373,945	17,456,647

5. Llogari të arkëtueshme tregëtare

Llogaritë e arkëtueshme tregëtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	ne Lek	ne Lek
Kliente	578,932	576,181
	578,932	576,181

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	ne Lek	ne Lek
ikub.al	6,804,000	10,805
ikubINFO shpk	11,373,000	9,992,732
	18,177,000	10,003,537

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	ne Lek	ne Lek
Investment Sherko	83,000	83,000
ikub.al	1,298,350	1,298,350
	1,381,350	1,381,350

“IT Panakeia” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	ne Lek	ne Lek
Tatim mbi fitimin	992,749	-
Te tjera kërkesa te arkëtueshme	3,496,941	2,324,904
	4,489,690	2,324,904

8. Inventari

Gjendja e inventarit më 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë :

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	ne Lek	ne Lek
Mallra	3,148,433	2,386,122
	3,148,433	2,386,122

“IT Panakeia” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

9. Aktive Afatgjata Materiale

	Automjetet	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Te tjera	Totali
Kosto					
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	4,960,810	220,964	4,789,857	3,443,590	13,415,221
Shtesa	0	187,367	377,678	47,001	612,046
Pakesime	-4,960,810				-4,960,810
Gjëndja më 31 Dhjetor 2016	0	408,331	5,167,535	3,490,591	9,066,457
Shtesa	0	15,000	39,642	78,970	133,612
Pakesime					0
Gjëndja më 31 Dhjetor 2017	0	423,331	5,207,177	3,569,561	9,200,069
Zhvlerësimi i akumuluar					
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	-3,124,456	-125,304	-3,150,510	-2,172,569	-8,572,839
Amortizimi i vitit	0	-40,626	-471,844	-262,806	-775,276
Pakesime	3,124,456				3,124,456
Gjëndja më 31 Dhjetor 2016	0	-165,930	-3,622,354	-2,435,375	-6,223,659
Amortizimi i vitit	0	-47,622	-388,793	-222,943	-659,358
Pakesime					0
Gjëndja më 31 Dhjetor 2017	0	-213,552	-4,011,147	-2,658,318	-6,883,017
Vlera neto kontabël					
Gjendja më 31 Dhjetor 2015	1,836,354	95,660	1,639,347	1,271,021	4,842,382
Gjendja më 31 Dhjetor 2016	0	242,401	1,545,181	1,055,216	2,842,798
Gjendja më 31 Dhjetor 2017	0	209,779	1,196,030	911,243	2,317,052

10. Shpenzime te periudhave te ardheshme

Gjendjet e shpenzimeve te periudhave te ardheshme me 31 Dhjetor 2017 dhe 2016 jane si me poshte:

	31 Dhjetor 2017 ne Lek	31 Dhjetor 2016 ne Lek
Shpenzime te periudhave te ardheshme	366,600	-
	366,600	-

11. Llogari të pagueshme tregëtare

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve për faturat e pranuar dhe ato të pambërritura. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

	31 Dhjetor 2017 ne Lek	31 Dhjetor 2016 ne Lek
Furnitore	1,196,664	389,593
Furnitore per fatura te pa mberitura	17,592	42,697
	1,214,256	432,290

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 2016:

	31 Dhjetor 2017 ne Lek	31 Dhjetor 2016 ne Lek
ikub.al	1,469,423	481,576
	1,469,423	481,576

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	ne Lek	ne Lek
Kontribute per sigurimet shoqerore dhe shendetesore	222,855	255,171
Tatimi mbi te Ardhurat nga Punesimi	44,952	3,740,805
Tatim ne Burim	21,228	21,584
Tatim fitimi	-	6,233
TVSH per t'u paguar	1,443,589	4,510,152
	1,732,624	8,533,945

14. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjera më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	ne Lek	ne Lek
Detyrime ndaj personelit	775,786	-
Divident i pagueshem - Investment Sherko	8,000,000	8,000,000
	8,775,786	8,000,000

15. Kapitali aksionar

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 400,000 leke i zoteruar 100% nga ortaku i vetem i shoqerise Investment SHERKO - ikub GROUP shpk.

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	ne Lek	ne Lek
Sherbime programimi	9,400,000	28,224,000
Sherbime mirembajtje	2,800,000	1,978,897
Te ardhura nga komisione ndermjetesimi	908,244	406,955
Te ardhura GIS	5,559,193	11,481,001
Shitje mallra	11,921,578	5,990,950
	30,589,015	48,081,803

17. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe të ardhura të tjera financiare, që detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	ne Lek	ne Lek
Fitime nga kembimet valutore	21,961	114,412
Humbje nga kembimet valutore	(54,454)	(194,635)
Te ardhura parkim me qera	-	69,845
Te ardhura nga shitja e AQ	-	1,836,354
Vlera e mbetur e AAM te dala	-	(1,836,354)
Te ndryshme	752	1,024
	(31,741)	(9,354)

Rakordimi i të ardhurave të deklaruara në FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar në FDP e TVSH është si më poshtë:

	Dhjetor 31, 2017
Rakordimi i te ardhurave me FDP-ne	
Shitje total te deklaruar ne FDP TVSH	30,589,015
Shitje te deklaruar ne FDP qe jane te ardhuran ne PASH	30,589,015
Shitje mallrash	11,921,578
Sherbime	18,667,437
Te ardhura te deklaruar ne PASH te cilat jane deklaruar shitje ne FDP	30,589,015
Te ardhurat nga interesat	752
Fitim nga kembimet valutore	21,961
Total te ardhura te deklaruar FDP e Tatim Ftimit	30,611,728

18. Lëndet e para dhe shërbimet

Shërbimet për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017 dhe atë të mbyllur më 31 Dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	ne Lek	ne Lek
Sherbime GIS	-	142,856
Kosto e mallrave te shitur	6,396,969	2,698,679
Sherbim reklamimi	1,868,938	910,820
	8,265,907	3,752,355

19. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	ne Lek	ne Lek
Qira Zyra	1,706,828	1,589,583
Qira platforma ebuy.al	2,000,000	1,166,667
Shpenzime reklame	-	16,000
Sherbime konsulence	473,300	1,074,403
Shërbime telefonike+internet+postare	2,268,853	1,029,196
Komisione bankare	160,112	146,032
Taksa vendore	67,000	122,834
Blerje kancelari dhe te ngjashme	78,255	165,909
Shpenzime udhëtimi e dieta	-	42,180
Konsum uje i pijshem	22,000	30,000
Shpenzime mirembajtje pajisje dhe zyre	851,805	461,339
Shpenzime karburanti	292,800	161,500
Shpenzime te ndryshme dhe te panjohura	287,483	580,175
	8,208,436	6,585,818

20. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	ne Lek	ne Lek
Shpenzime per paga	11,592,073	27,158,321
Shpenzime per sigurime shoq e shend	1,653,862	1,418,691
	13,245,935	28,577,012

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2017 është 20 (2016:20).

21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjobat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
	ne Lek	ne Lek
Gjoba dhe penalitete	302	302
	302	302

“IT Panakeia” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

22. Shpenzime financiare Neto

	<u>31 Dhjetor 2017</u> ne Lek	<u>31 Dhjetor 2016</u> ne Lek
Shpenzime interesa banka	30	25
	30	25

23. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2016;15%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 Dhjetor</u> 2017	<u>31 Dhjetor</u> 2016
Fitimi para tatimit	177,306	8,381,661
Shpenzime te panjohura te tjera (si me poshte)	223,498	354,712
Shpenzime udhetimi	-	26,180
Penalitet, gjoba e demshperblime	302	302
Shpenzime te tjera	223,196	328,230
Fitimi para tatimit (perfshire shpenzimet e panjohura)	400,804	8,736,373
Humbje fiskale e mbartur	400,804	8,736,373
Tatim fitimi @15%	60,121	1,310,456
Fitimi/humbja e Vitit	117,185	7,071,205

24. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

Bilanci kontabël	<u>31 Dhjetor 2017</u>	<u>31 Dhjetor 2016</u>
<i>Të pagueshme ndaj paleve te lidhura</i> ikub.al	1,469,423	481,576
	1,469,423	481,576

“IT Panakeia” shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Vlerat janë në Lek)

Të arketueshme nga palët e lidhura

ikub.al	6,804,000	10,805
ikubINFO shpk	11,373,000	9,992,732
	18,177,000	10,003,537

31 Dhjetor 2017
ne Lek

31 Dhjetor 2016
ne Lek

Hua Afatshkurtra te dhena

Investment Sherko	83,000	83,000
ikub.al	1,298,350	1,298,350
	1,381,350	1,381,350

Për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2017

Për vitin e mbyllur
më 31 dhjetor 2016

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

Shitje palëve të lidhura

ikubINFO	11,155,000	37,716,340
ikub.al	5,670,000	9,004
	16,825,000	37,725,344

Blerje nga palët e lidhura

ikub.al	2,387,851	2,049,047
	2,387,851	2,049,047

25. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë çeshtje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kerkoje rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2017. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme.

26. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.